

## **AKT THEMELIMI**

I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR



**Sh.p.k**

24 Prill 2018

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**"Skyline Construction" Sh.p.k.**

Bazuar në ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare", dhe ligjit 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", ne të nënshkruarit:

1. **Znj. Luljeta Seitaj**, e bija e Fejzi, lindur në Tirane (Shqiperi), më 05.10.1964, shtetase Shqiptare, banues në Rruga Ali Demi, Pallati 249, Shkalla 1, Apartamenti 4, Tirane, titulare e Ieternjoftimit (ID )nr. 025078074 dhe nr. personal. G46005149V, leshuar me date 24.04.2009.

Në përputhje me vullnetin e saj të lirë themeloj shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar "Skyline Construction", Sh.p.k. sipas kushteve të mëposhtme:

**Neni 1 – Emri**

Themeluesja Znj. Luljeta Seitaj, do të krijojë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar e cila do te quhet "Skyline Construction"Sh.p.k.

**Neni 2 – Selia**

Selia e shoqërisë është në adresën: Rruga Ali Demi, Pallati 249, Shkalla 1, Tirane.

**Neni 3 - Objekti**

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë:

Investimi në pasuri të paluajtshme si dhe zhvillimi, shitja, blerja e trojeve, ndërtesave, njësive dhe apartamenteve etj.

Çdo lloj aktiviteti i lejuar nga legjislacioni në fuqi.

**Neni 4 – Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë është me nje kohe te pacaktuar, kohëzgjatje e cila mund të shtyhet me vendim të Asamblesë së Përgjithshme.

**Neni 5 – Drejtimi**

Organet Drejtuese të Shoqërisë janë:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve, që përbëhet nga themeluesi (Ortaku i Vetem), dhe

2. Administratori

Shoqëria do të administrohet nga një administrator që emërohet për një periudhë prej 5 (pesë) vjeçare. Administratori e pare të shoqërisë do të jetë:

1. **Z.Florjan Çausi**, i biri i Skender, lindur në Tirane (Shqiperi), më 14.03.1985, shtetas Shqiptar, banues në Rruga Sravri Themeli nr. 29, Njesia Bashkiake nr.7, Tirane, titular I Leternjoftimit (ID)nr. 024439114, dhe nr. personal I50314074M, lëshuar me date 25.02.2009.

**Neni 6 – Kapitali**

Kapitali fillestar i Shoqërisë ( 10,000 ) Leke, Kapitali themeltar shlyhet nga themeluesi.

Ortaku themelues do të zotërojë kapitalin themeltar të shoqërisë si më poshtë:

- Znj. **Luljeta Seitaj**, do të zotërojë një kuotë me vlerë nominale ( 10.000) Lekë e cila do të përfaqësojë 100% të kapitalit të shoqërise;

**Neni 7 – Viti Ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon më 1 Janar dhe mbyllet më 31 Dhjetor të çdo viti. Viti i parë ushtrimor fillon ditën e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar të shoqërive dhe mbyllet më 31 Dhjetor 2018.

**Neni 8 – Të tjera**


Shoqëria krijohet dhe do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me ligjet shqiptare në fuqi, Ligji 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe ligje të tjera që do të jenë në fuqi gjatë periudhës së aktivitetit të shoqërisë, si dhe në përputhje me statutin që do të konsiderohet pjesë përbërëse e këtij akti.

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) ekzemplarë, në gjuhën shqipe duke patur secili ekzemplar fuqi të njëjtë ligjore.

Ky akt pasi u lexua nga ortakët themelues dhe pasi është gjetur në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe firmoset rregullisht në datë 24 Prill 2018.

Emri dhe firma e ortakut:

- Znj. **Luljeta Seitaj**:

  
(emër, mbiemër, firmë)